

DEKLARATË

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rëndësinë e madhe dhe nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve dypalëshe strategjike me Greqinë, si dhe vullnetin e dyanshëm për t'i përmirësuar e thelluar ato në të mirë të dy vendeve dhe popujve tanë, si dhe kontributin për forcimin e paqes, sigurisë dhe bashkëpunimit në rajonin tonë,

Duke mbajtur parasysh se dy vendet tona janë anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe në këtë kuadër bashkëpunojnë pa rezerva për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes sonë të përbashkët;

Duke mbajtur shënim kontributet e përbashkëta të vendeve tona në organizatat e bashkëpunimit për paqen, sigurinë dhe të drejtat e njeriut, në radhë të parë OSBE-së dhe KfE-së;

Duke vlerësuar kontributin e Greqisë për ecjen përpara të proceseve integruese në Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe bashkëpunimin në organizatat rajonale përkatëse;

Duke mbajtur parasysh se midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë është nënshkruar Traktati i Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë;

Duke mbajtur shënim se marrëdhëniet mes vendeve tona kanë ecuri pozitive dhe se të dyja vendet, në frymën e mirëkuptimit dhe në të mirë të dy popujve tanë, kanë bashkëpunuar për të zgjidhur çështjet e hapura mes vendeve tona;

Vëren se ndryshe nga fryma e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë, si dhe nga vullneti politik i dyanshëm i shprehur në mënyrë të përsëritur, ligji i luftës nr. 2636/40 mbetet ende në fuqi dhe vijon të prodhojë disa efekte negative që lindin kur shtetet janë në gjendje lufte.

Me synimin dhe dëshirën për të zgjidhur edhe këtë çështje të trashëguar nga një e kaluar që nuk mund të kthehet,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

I bindur në vullnetin e mirë të Parlamentit të Republikës së Greqisë për t'u dhënë shtysë pozitive marrëdhënieve dypalëshe me Shqipërinë, duke bërë përpjekje konstruktive për të zgjidhur çdo çështje të hapur, fton Parlamentin e Republikës së Greqisë të mbështesë përpjekjet e qeverisë për jetësimin e vullnetit politik të shprehur më shumë se një herë nga ministrat e Jashtëm të Republikës së Greqisë për abrogimin e ligjit të luftës nr. 2636/40 me Shqipërinë dhe në këtë frymë pozitive të marrë në konsideratë e të miratojë çdo instrument ligjor që do t'i shërbente korrigjimit të kësaj situate që nuk përputhet me realitetet e marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri–Greqi.

Në përputhje me angazhimin ndërparlamentar të parashikuar në Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit Reciprok, Sigurisë mes dy vendeve, ne bëjmë thirrje të krijohet një grup pune mes dy parlamenteve, që të kontribuojë zyrtarisht në këtë drejtim ose në adresimin e çdo problemi të ngjashëm në marrëdhëniet mes dy vendeve tona sipas parimeve të njohura të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjithashtu, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

I kërkon Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të bëjë çdo përpjekje me qeverinë e Greqisë për abrogimin e ligjit të luftës nr. 2636/40 dhe pasojat juridike që burojnë nga ky ligj.

I kërkon Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që në vijim të kontributeve të konfirmuara të politikës sonë të jashtme për fqinjësi të mirë, për paqe dhe për siguri, të mbajë të informuar rregullisht Kuvendin e Shqipërisë dhe partnerët tanë euroatlantikë, NATO-ja dhe BE-ja, për përpjekjet sistematike të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me qeverinë e Republikës së Greqisë, për zgjidhjen e kësaj çështje të bartur nga e kaluara.

Miraturar në datën 18.7.2024.

KRYETARE
Lindita Nikolla

